



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI  
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT  
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

Prishtinë, 24 Mars 2020

I nderuari Kryeministër,

Mbrëmë ke nënshkruar një vendim me të cilin i shkel të drejtat dhe liritë e njeriut të qytetarëve të Republikës së Kosovës e që garantohen me Kushtetutën e Kosovës si dhe me konventat ndërkombëtare.

E kam fjalën për vendimin 01/15 me datë 23.03.2020 me të cilin Qeveria synon të ndalojë qarkullimin e qytetarëve dhe të automjeteve private në Kosovë nga data 24 mars 2020 në mes orëve 10:00 e 16:00 dhe 20:00 – 06:00, përveç në përjashtimet që janë radhitur në pikat 1 dhe 2 të këtij vendimi.

Kufizimi i lëvizjes së qytetarëve në territorin e Kosovës paraqet shmangie nga të drejtat dhe liritë që mbrohen qartë me Kushtetutën e Kosovës.

Ju thirrreni në nevojën për të parandaluar përhapjen e virusit COVID-9. Po u a përkujtoj se për këtë arsye unë pata iniciuar shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme, që do t’ua mundësonte institucioneve të Kosovës që të ndër marrin në mënyrë të ligjshme dhe në përputhje me Kushtetutën e Kosovës hapat gjegjës për të parandaluar përhapjen e COVID-19.

Ju patët refuzuar me ashpërsi dhe pa asnjë argument shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme.

Unë sot i jam drejtuar Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar interpretim dhe për të ndaluar këtë shkelje të të drejtave dhe lirive të qytetarëve të garantuara me Kushtetutën e Kosovës.

Duke dashur që të ruhet rendi Kushtetues dhe ligjor në Kosovë, ju ftoj që të shfuqizoni vendimin e mbrëmshëm, ose së paku ta pezulloni implementimin e tij deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Singerisht,

Hashim Thaçi

Presidenti i Republikës së Kosovës

SH.T. Z. Albin Kurti

Kryeministër i Republikës së Kosovës